

# Familja si Shkollë e Dashurisë, Shpresë e Paqes Afatgjatë!

15 Maj 2016, Prishtinë – Kosovë

Në 15 Maj 2016 FFPBB, W-CARP dhe FPU Prishtinë organizuan projektin me temë: “Familja si shkollë e dashurisë, shpresë e paqes afatgjatë”. Argumenti bazë që na nxiti të realizojmë një projekt të tillë ishte që: “Familja është në rrezik, e ne nuk mund të qëndrojmë thjesht pasivë, pa bërë asnjë gjë për të ndikuar në opinionin publik”. Edhe pse me kapacitete të vogla aktive në anëtarë, ne vendosëm që në Ditën Ndërkombëtare të Familjes të mos ishim memecë, duke hedhur një hap të parë me shpresën që dikur FFPBB të bëhet zëri kryesor në këtë ditë.

Ky projekt kishte tre pjesë kryesore, duke ngjasuar kështu me projektin “Promovimi i Dashurisë së Pastër”, por në përmbajtje ka disa elementë shtesë.



Kështu, pjesa e parë e projektit edhe këtë herë ishte shpërndarja e panfletave, ku përshkruhej tema kryesore dhe paraqitej ftesa për aktivitetin. Për katër ditë rresht, ne u gjendëm para Teatrit Kombëtar të Kosovës, nën shoqërinë e këngëve inspiruese si “We are the World” etj., me baner në sfond e tavolinë për regjistrime, (një miniskenë e vogël për ne), duke takuar e sqaruar kalimtarët, duke u dhënë panfleta e një shprehje nga Babai i Vërtetë. Gjithsej u shpërndanë 1500 panfleta të cilat frymëzuan pjesën më të madhe të kalimtarëve që na falenderonin për nismën. Por jo vetëm ata, edhe anëtarët frymëzoheshin nga reagimi që kishin personat ndaj panfletave e motove që lexonin, pasi motot pëlqeheshin shumë dhe dëshironin t’i mbanin me vete në kuletë. Këtë herë në organizim ndihmuan edhe ambasadorët e paqes si: Z. Ismail Kurteshi i cili mori 100 panfleta për t’i shpërndarë në Gjilan, dhe Z. Daut Demaku i cili referoi leksionin “Familja si Shkollë e Dashurisë”.

Nga ky reagim kaq pozitiv ne menduam që pjesëmarrja në marrshim do ishte shumë e madhe, por mesa duket është akoma herët të pritet një guxim i tillë nga ana e qytetarëve, për çështje të tilla, apo sakrificë të punëve personale qoftë edhe për një qëllim fisnik. Gjithsesi, bazuar te reagimet, besojmë që shumë zemra e mendje u bashkuan me ne...



Pjesa e dytë e projektit u zhvillua më 13.05.2016, ditën finale, ku përveç shpërndarjes së panfletave, motove, dhe bisedës me kalimtarët, u bë dhe një marrshim paqësor në promovim të vlerave të familjes nga sheshi Skënderbe deri te Biblioteka Kombëtare. Duke qenë se pjesëmarrja në shesh ishte shumë më e vogël nga çfarë pritej, për të stimuluar pjesëmarrjen, Savjola e shoqëruar nga Era bënë një marrshim paraprak në shesh, duke bërë thirrje të bashkoheshin të gjithë. Rezultati i vetëm ishte se me dhjetra persona dëgjuan me kuriozitet, por nuk u bashkuan. Kështu në orën 14:00 kur ishte parashikuar, marshimi filloi me 15 anëtarë, dhe 5 të ftuar. Dy baballarë të zhgënjyer nga mospjesëmarrja e të tjerëve na shoqëruan nga larg deri te Salla e Kuqe e Bibliotekës Kombëtare ku u zhvillua faza e tretë e projektit.



Te salla e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës na prisnin edhe ambasadorë të tjerë për paqen, e të rinj të tjerë që nuk u bashkuan me marrshimin, gjithsej u bëmë 30 persona. Moderimi i aktivitetit u bë nga Savjola Konja. Programi u hap me një video motivuese e më pas të pranishmit dëgjuan z. Daut Demaku, i cili mbajti një fjalim hyrës e më pas dha leksionin "Familja si Shkollë e Dashurisë".

Pas përfundimit të aktivitetit të rinjtë e interesuar u regjistruan, ndërsa anëtarët u mbledhën te zyrat tona duke diskutuar çfarë u bë dhe çfarë mund të ishte bërë më mirë.

Një intervistë e lidhur me aktivitetin u publikua te gazeta “sovrani.info” on-line.

<http://www.sovrani.info/te-reflekojme-per-nje-familje-te-shendoshe/>



Faleminderit, dhe Zoti ju bekoftë!